LIGJ
Nr. 25/2017

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 1, DATË 25.1.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9136, DATË 11.9.2003, "PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 25.1.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", me ndryshimin e mëposhtëm:

Neni 4 i aktit normativ riformulohet si më poshtë:

"Neni 4
Dispozita të fundit

Me hyrjen në fuqi të këtij akti normativ, shfuqizohen:

a) fjalët, "e vetëpunësuar, të cilët marrin pension dhe që ushtrojnë, të vetëm, veprimtari ekonomike profesionale, sipas nenit 9 të këtij ligji.", të nenit 1, të ligjit nr. 144/2015, "Për disa shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar";

b) neni 2, i ligjit nr. 144/2015, "Për disa shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar";

c) nenet 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 145/2015, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 383, datë 24.2.2011,"Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", që ka ndryshuar përkatësisht nenin 5, pika 1, shkronjat "b" dhe "c"; nenin 6, pika 1, dhe paragrafin e dytë, të pikës 3, të nenit 7, të ligjit.".

Miratuar në datën 9.3.2017

Shpallur me dekretin nr. 10094, datë 23.3.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani